



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	14.04.2026
<b>REFERENC-Ë:</b>	25/7292/604/DMM
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Kompania "Ndërmarrja e Re Bujku" Sh.p.k. Rogoçicë, Kamenicë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Bajram Kafexholli , U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 25/7292/604/ DMM, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Përfundim të procedurës administrative** të kërkesës së Kompanisë "Ndërmarrja e Re Bujku" Sh.p.k. Rogoçicë, Kamenicë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "Ndërmarrja e Re Bujku" Sh.p.k. Rogoçicë, Kamenicë, e cila ka aplikuar për Thertore të Gjedheve dhe Përpunim të Mishit në Z.K. Hodonoc, Kamenicë, me nr.prot. 25/7292/604/ DMM, të datës 02.10.2025.**

**A r s y e t i m**

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Ndërmarrja e Re Bujku" Sh.p.k. Rogoçicë, Kamenicë, është konstatuar se:

- Emri i Kompanisë i shënuar në aplikacion nuk është i njëjtë me atë në Çertifikatën e Biznesit;
- Te Plani i Situacionit nuk vërehet qartë vula e Gjeodetit të licencuar;
- Mungon Pëlqimi/Njoftimi nga Komuna.

Faqe 2 nga 3



Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Ndërmarrja e Re Bujku" Sh.p.k. Rogoçicë, Kamenicë, me datën 13.10.2025 i është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara nuk janë sjellë në bazë të njoftimit për plotësim dokumentacioni.

Bazuar në të lartcekuat, Sekretari i Përgjithshëm të MMPH-së merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për pajisje me Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Ndërmarrja e Re Bujku" Sh.p.k. Rogoçicë, Kamenicë.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

**Vërejtje:** Afati për shqyrtimin e lëndës është tejkaluar për shkak të zëvendësimit të Sekretarit të MMPH-së.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Nr.: 25/7292/1- ZSP/ /26, datë: 14.04.2026  
Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Kamenicës
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
6. Divizioni për Komunikim me Publikun
7. Arkivit të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH